



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
ZV/KRYETARI

Nr. 5033 prot.

Gramsh, më 21/12 /2023

RELACION

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.77, DATË 30.11.2023 PËR
“TRAJTIMIN EKONOMIK TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2023-
2024”

KËSHILLIT BASHKIAK
GRAMSH

Të nderuar Këshilltarë!

Në datë 20.12.2023 ka ardhur një kërkesë për t’u trajtuar me bursë studimi për nxënësin Mikel Albert Murati, i cili është i regjistruar në shkollën e mesme profesionale “Gjergji Canco” Tiranë, në drejtimin Elektroteknikë, klasa X-të, regjistruar për herë të parë në vitin shkollor 2023-2024.

Duke qënë se sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.19749 prot, datë 30/10/2023, regjistruar në institucionin tonë me nr.4280 prot., datë 01/11/2023, për bashkinë Gramsh janë rakorduar 35 (tridhjetë e pesë) bursa dhe ne kemi miratuar vetëm 22 (njëzet e dy) bursa sipas vendimit nr.77, datë 30/11/2023 për “Trajtimin ekonomik të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore profesionale për vitin shkollor 2023-2024”, pra kemi akoma bursa të pazezuruara dhe duke qënë se nxënësi Mikel Albert Murati i plotëson kriteret për të përfituar bursë mbështetur në VKM nr.666 datë 10.10.2019 për **“Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik, i ndryshuar, pika 2.3 gërma d**, ku citohet se përfitojnë bursë sipas kriterit joekonomik nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit.

Në rastin konkret nxënësi Mikel Murati ka babain Albert Murati i cili trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar në shumën 7729 (shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) lekë në muaj, me numër dosje 1078.

Për këto arsye, Ju ftojme që të votoni projekt –vendimin e paraqitur.

ZV/KRYETARI
Ergita KASO

JURISTI
Elidjan KOÇI

KRYETARI
Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5033 prot.

Gramsh, më 21/12/2023

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ .12.2023

PËR

MIRATIMIN ME NJË SHITESË TË LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR QË FREKUENTOJNË NË SHKOLLA PROFESIONALE TË ARSIMIT TË MESËM PUBLIK TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSËS PËR VITIN MËSIMOR 2023-2024.

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 27/12/2023 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe VKM. nr.666 datë 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik”, i ndryshuar, V.K.M nr.51 datë 27.07.2022, për vitin mësimor 2023-2024, si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga zv/Kryetari i Bashkisë.

VENDOSI

1. Të miratojë shtesën në vendimin nr.77, datë 30/11/2023 për “Trajtimin ekonomik të nxënësve të arsimit parauniversitar që frekuentojnë në shkolla profesionale të arsimit të mesëm publik, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin mësimor 2023-2024”.
2. Të trajtohet me bursë të plotë, 100% bursë, nxënësi Mikel Albert Murati, i cili studion në shkollën e mesme profesionale “Gjergji Canco” Tiranë në drejtimin Elektroteknikë, klasa X-të, regjistruar për herë të parë në vitin shkollor 2023-2024 dhe plotëson kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2023-2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSH. BASHKIAK
XHULIA GJINI

KRYETARI I KËSH. BASHKIAK
ENIS ZANI